



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

Nr. _____, datë _____. _____. 2023

PËR

CAKTIMIN E MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL SI ORGAN PËRGJEGJËS PËR REALIZIMIN E PROCEDURËS SË DERATIZIMIT TË BIMËS SË GËSHTENJËS, ME QËLLIM MBROJTJEN E SAJ NGA PARAZITI GRERËZA GALEFORMUESE (*DRYOCOSMUS KURIPHILUS HYMENOPTERA: CYNIPIDAE*)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 5, të Ligjit Nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të Ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të Ligjit Nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, të Ligjit Nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, dhe të Ligjit Nr. 57/2020, “Për pyjet”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Caktimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si organ përgjegjës për realizimin e procedurës së deratizimit të bimës së gështenjës, me qëllim mbrojtjen e saj nga parazitit grerëza galeformuese (*Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera: Cynipidae*).
2. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ngarkohet për kryerjen e prokurimit dhe lidhjen e kontratës për kryerjen e shërbimit, sipas pikës 1, të këtij vendimi, si dhe monitorimin e zbatimit të kontratës.
3. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP), në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore/bashkitë, të monitorojnë respektimin e kërkesave teknike trajtuese, të vendosura në zbatim të këtij procesi.
4. Fondi për procedurën e prokurimit publik të përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2023, për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, shpenzimet korrente në programin buxhetor “*Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit*”, produkti “*Sipërfaqe e Trajtuar dhe e Mbrojtur nga Parazitët në Fushën e Bujqësisë*”.

5. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP), si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore/bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama